



T | PRVW00 | 0

ZALIJEPITI NALJEPNICU UÇENIKA



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I NJOHURIVE TË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE

PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026

UDHËZIME

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË: 70 MINUTA.

Mjetet e lejuara: lapsi grafit, goma dhe stilolapsi.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore. Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.

Nëse gabon në zgjidhjen e detyrës, vijëzoje dhe zgjidhe përsëri.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Zgjidhjen e detyrës/pyetjes DUHET patjetër ta shkruani në vendin e paraparë për atë detyrë/pyetje.

GJATË PUNËS NË TEST NUK LEJOHET PËRDORIMI I PAJISJEVE ELEKTRONIKE DHE KORREKTUESIT.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- ▶ është e pasaktë
- ▶ zgjidhja është shkruar në vendin që nuk është parashikuar për atë detyrë/pyetje
- ▶ është e palexueshme dhe nuk është e qartë
- ▶ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë.

TË UROJMË SHUMË SUKSES!



T | PRV00 | 1

Në bazë të tekstit 1 dhe tekstit 2, përgjigju pyetjeve 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Teksti 1

TEATRI POPULLOR I  **PRINCIPATËS SË MALIT TË ZI**

N Ë C E T I N Ë

== Nga dashamirësia ndaj teatrit, është mysafir z. MIHAJLLO MARKOVIQ, anëtar i Teatrit Mbretëror Kroat të Zagrebit ==

SHFAQJA XI SHFAQJA XI

Sot, të dielën më 20 qershor 1910, në Shtëpinë e Zetës

REVIZORI

Komedi në 5 akte. Shkruar nga N. V. Gogol. Përkthyer nga P. Todoroviq Regjia: z. M. Petroviq.

PERSONAZHET:

ANTONIJE ANTONOVIĆ DMUHOVSKI, kryetar i qarkut	z. M. Markoviq
ANA ANDREJEVNA, gruaja e tij	z-nja Petroviq
MARIJA ANTONOVNA, vajza e tij	z-nja Angjellkoviç
LLUKA LLUKIQ, mbikëqyrës i shkollave	z-Gllasoviq
AMOS FJODOROVIÇ LJAPKIN-TRAPKIN, gjykatës	z. Petroviq
ARTEMIJE FILIPOVIQ ZEMLJANIKA, kujdestar i spitalit	z. K. Martinoviq
IVAN KUZMIQ Shpekin, postier	z. L. Taminxhiq
PETAR IVANOVIQ DOBÇINSKI, bejlerë të qytetit	z. Pejoviq
PETAR IVANOVIQ BOBÇINSKI, bejlerë të qytetit	z. Kovaçeviq
IVAN ALEKSANDROVIÇ HLJESTAKOV, nëpunës nga Petrogradi	z. M. Stevanoviq
OSIP, shërbëtori i tij.	z. M. Petroviq
SHËRBËTOR I HANIT	z. M. Taminxhiq
XHANDARI	

Aktet I, III, IV dhe V zhvillohen në shtëpinë e kryetarit Dmuhovski, ndërsa akti II në dhomën e mysafirëve.

ÇMIMET:

LOZHAT E SIPËRME – 8 perperë — LOZHA E POSHTME 8 Perp. — PARTERI rreshti I 1.50 Perp.
PARTERI rreshti II 1.50 Perp. — Qëndrim në parter 0.80 Perp. — Galeria 0.40 Perperë.

Biletat mund të merren në ditën e shfaqjes në administratën e Teatrit Popullor Mbretëror të Malit të Zi nga ora 15:00–16:00 pasdite dhe në mbrëmje nga ora 19:00 në arkë.

👉 **Fillimi saktësisht në orën 20:00 në mbrëmje.** 👈



Teksti 2

Drama *Revizori* e N. V. Gogolit, pa dyshim, bën pjesë ndër komeditë shoqërore më të njohura dhe më të mira, sepse është sinonim jo vetëm i kohës së dikurshme, por edhe i kohës sonë. Ajo merret me natyrën njerëzore dhe dukuritë negative, por është edhe komedi karakteri dhe situatë, sepse shtrembërimi moral, vlerat shoqërore të përmbysura, hipokrizia dhe mungesa e karakterit janë të përjetshme. Tallja e gjendjes shoqërore dhe e natyrës njerëzore është temë e marrë nga realiteti shoqëror i Rusisë cariste në gjysmën e parë të shekullit XIX. Ideja e komedisë përmbahet në një deklaratë të vetë Gogolit:

“Në *Revizorin* kam dashur të mbledh në një grumbull të gjitha të shëmtuarat në Rusi që i njihja atëherë, të gjitha padrejtësitë që bëhen në ato vende dhe në ato rrethana ku nga njeriu kërkohet më së shumti drejtësi, dhe njëkohësisht të tallem me gjithçka.”

1

Çfarë është e përbashkët dhe çfarë është e ndryshme midis tekstit 1 dhe tekstit 2?

2



T | PRV00 | 3



P | WM4AQ | 3

2

Kur zhvillohet ngjarja e veprës *Revizori*?

1. me njëzet qershor 1910
2. në gjysmën e parë të shekullit XIX
3. në kohën tone

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1



P | A52EA | 3

3

Nëse pohimi është i saktë, rretho S, e nëse nuk është i saktë, rretho P.

POHIMI	SAKTË	PASAKTË
<i>Revizori</i> tall dukuritë negative në shoqëri.	S	P
Performansa <i>Revizori</i> jepet nga Teatri Mbretëror Kroat i Zagrebit.	S	P
Mihajlo Marković është anëtar i Teatrit Popullor të Principatës së Malit të Zi.	S	P

1



T | PRVW00 | 4

4



P | XQNJL | 4

Lloji letrar ku bën pjesë vepra *Revizori* është:

1. drama
2. komedia
3. tragjedia

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1

5



P | CYUJM | 4

**Vepra *Revizori* ka ndarje sipas personazheve.
Arsyeto pohimin.**

1

**Në bazë të fragmentit, si dhe të veprës në tërësi, përgjigju pyetjeve 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.**

Dëgjohet zëri i brishtë, më i buçitshëm, që paralajmëron sulmin e menjëhershëm në kështjellën e mbretëreshës. Kthehet e çmeritur, e vendos kamxhikun e artë, parzmoren e çunit, thikën dhe gotën e helmit në dollap. I afrohet dritares, vendos duart në skajet e saj dhe u drejtohet pushtuesve, që nuk shihen, me zë të vendosur dhe të lartë” .

Keni kaluar shtrëngatat, detet dhe shkëmbinjtë që të pushtoni tokat e mia. Mendoni se këtu do të gjeni qetësinë? Keni harruar se qetësia juaj do të varet prej nesh, ashtu siç varet gjithmonë paqja e pushtuesit prej durimit të të pushtuarit. Jo. Nuk na njihni mirë. Ju keni marrë guxim prej fatkeqësisë sime dhe prej urrejtjes suaj. Guximi juaj do të jetë edhe fatkeqësia juaj. Ju do t'i shihni kufijtë e vetes kur t'i kaloni kufijtë.

Nuk e dini se prej luleve këtu bëhen shpesh ujquit, prej kaprojve lindin shpesh arinjtë; prej dafinave farkohen shpesh shigjetat, kurse prej mjedisit bëhet shpesh helmi. Ju nuk e njihni këtë popull. Nuk e duron ai shpatën e të vetit e aq më pak e duron shpatën e të huajit. Ky popull e vë krenarinë mbi lumturinë. Përmbi malet tona fluturojnë shqiponjat dhe prej tyre jemi mësuar të çmojmë mbi çdo gjë tjetër lirinë. Edhe buka na duket e ëmbël, edhe gruri na duket i butë; edhe malet na duken fusha; edhe dimri na duket pranverë vetëm kur jemi të lirë. Ne i kemi këputur gjithmonë prangat dhe do t'i këpusim aq më shpejt prangat tuaja. Si nuk keni mësuar prej ushtarëve të mi? A ka ngjarë ndonjë herë të zini ndonjë rob dhe ta bëni skllav? Jo. Tani mendoni se do ta shtini në duart bazileshën e tyre! Jo. Nuk do ta shtini në duar as të gjallë, as të vdekur. Kufomën e saj do ta lëshojë dheu dhe s'do ta shihni kurrë me sytë tuaj. Do të bindeni se edhe pushtimi juaj do të dëshmojë namin tim. Namin e bazileshës, që s'ju ka lënë kurrë të qetë.

(I largohet fronit dhe i afrohet bustit të perëndisë Medaurus para të cilit gjunjëzohet dhe fillon të lutet).

Perëndi? Pse hesht? Fol, së paku sot, mos të shkoj pa ta njohur zërin.

Kurrë nuk ta kam dëgjuar fjalën edhe pse kurrë vullnetin tim s'e kam vënë mbi vullnetin tënd. Ti me heshtje e ke drejtuar fatin tim dhe fatin e popullit tim: të keqen dhe të mirën t'i kemi pranuar njësoj. Kurrë s'të kam lutur si sot, sepse kurrë s'kam dashur ta shqetësoj heshtjen tënde. E, sot? Jam pajtuar me vdekjen time, por mos u pajto Ti me pushtimin e popullit tim. Perëndi! Bëj që nami i tij të mos shuhet!

.....



T | PRV00 | 6

6



P | NCJH8 | 6

Duke u bazuar në fragment, plotëso tabelën.

Titulli i veprës	Emri dhe mbiemri i autorit	Gjinia letrare	Lloji letrar

2

7



P | JC4JR | 6

Personazhi kryesor i veprës është:

1. mbreti
2. mbretëresha
3. princesha
4. shërbëtorja

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1



T | PRV00 | 7



P | 7VXF | 7

8

Në çfarë momenti zhvillohet kjo vepër?

1



P | 3ETS8 | 7

9

Si paraqitet pushteti në këtë vepër?

1. Si burim lumturie
2. Si lojë argëtuese
3. Si ëndërr e bukur
4. Si barrë që sjell vetmi

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1



10



P | VB6KC | 8

Çfarë funksioni ka monologu në vepër?

1. Të përshkruajë vendin e zhvillimit të ngjarjes
2. Të shprehë mendimet e brendshme të personazhit
3. Të tregojë veprime luftarake që bëheshin atë kohë
4. Të paraqesë dialog mes personazheve të veprës

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1

11



P | N2RMR | 8

Çfarë mëson lexuesi nga kjo vepër?

1

**Lexo vargjet e poezisë “Drilon” nga Agim Vinca, pastaj përgjigju pyetjeve 12 dhe 13.**

Nga thellësia e kohërave na erdhi emri yt
i ri dhe i paplakur, Drilon.

Nga thellësia e viteve që shkuan
gjashtë tinguj si gjashtë rrufe vezulluan

D
r
i
l
o
n

Rrjedhë e pandalur e kohës
Drilon, breg i pamposhtur.
Nga arenat e shekujve doli emri yt
portreti yt i përgjakur-

lum i lindjes dhe i vdekjes sonë.
Nga thellësitë e shekujve dole
me sy të zgurdulluar
Drilon, rrjedhë e trazuar.

12

P | 8N662 | 9

Çfarë lirike jenë vargjet e dhëna, çka tregon emri Drilon në këtë poezi dhe cila figurë letrare është përdorë në vargun e dytë?

3



T | PRVW00 | 10

13



P | R4QCK | 10

Sqaro domethënien e vargut “Rrjedhë e pandalur e kohës”.

1

14



P | VZCTQ | 10

Në bazë të vargjeve plotëso tabelën.

VARGJET	TITULLI	LLOJI LETRAR
Ka ra rrezja nder bajama! T' bin e vet kshtu e pvetë e ama: -Ç'ke, moj bi, qi kjan e fshan? Kjan e fshan, e vetullat vran?-		
Ky shpirt plot njerëzi që po largohet, Përpara kohe i thirur në atë jetë, Në qiell do zërë vend me të vërtetë, Ashtu siç e meriton, nëse do çmohet.		

2



15



P | EZKYF | 11

Analizo fjalën e nënvizuar në aspektin morfologjik.

Autobusi mbërriti sot në stacion në orën shtatë.

Klasa e fjalës - _____

Gjinia - _____

Rasa - _____

1

16



P | GGQZQ | 11

Në fjalitë e mëposhtme shkruaj foljen në kohën e duhur:

Gjyshi (mbështes – më se e kryer) _____ dorën në supin e nipit.

Në jetën tuaj nuk (dëgjoj – e kryera) _____ një gjë të tillë.

2

17



P | MLZ9W | 11

Shkruani shkronjën Ç, ZH ose SH aty ku mungon, në mënyrë që fjala të jetë e shkruar saktë.

___fletoj; ___vendos; ___gardhoj; ___prish

1



18



P | N89SF | 12

Rretho numrin para fjalisë që është shkruar në stilin administrativ.

1. Për mua nuk ke pasur kurrë kohë.
2. Aplikimet dorëzohen në zyrën numër 12.
3. Do të dërgoj të dhënat gjatë orarit të punës.
4. Nesër mban mot me diell dhe vranësira të pjeshme.

1

19



P | N3YVS | 12

Vendosi fjalët e mëposhtme në rendin përkatës.

APOFONI: _____

METAFONI: _____

2



T | PRVW00 | 17



T | PRVW00 | 18



T | PRVW00 | 19

